



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org.Jedinica Org Unit	Nr. Prot: B. qj Prot: Prot. No.
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	Data: Datum: Date:
Prishtinë / a	



Memorandum Mirëkuptimi

në mes

Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës

dhe

Muller Health Consulting

Memorandumi Mirëkuptimit (në tekstin e mëtejme "Memorandum") përcakton kushtet e mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Shëndetësisë në Kosovë dhe Muller Health Consulting për projektin që ka të bëjë me vlerësimin dhe zbatimin e sistemeve të buxhetimit dhe pagesave të bazuara në DRG për Republikën e Kosovës.

1. Historiku

Gjatë viteve të fundit, Republika e Kosovës ka themeluar Fondin e Sigurimeve Shëndetësore (në tekstin e mëtejme "Fondi"). Në vitin 2020, pritet të fillojnë mbledhja e kontributeve nga qytetaret e Republikës së Kosovës në Fond. Rëndësi të madhe ka shpërndarja e fondeve të mbledhura në mënyrë të drejtë dhe transparente drejtuesve të kujdesit shëndetësor. Kjo është arsyeja pse Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore dhe Muller Health Consulting do të bashkëpunojnë për të zbatuar një sistem të financimit të bazuar në DRG (Grupet e lidhura me Diagnostikimin) për spitalet dhe pagesat e bazuara në kapitacion për kujdes parësor shëndetësor.

2. Qëllimi

Ky Memorandum përcakton qëllimet e partneritetit si në vijim:

- Implementimin e një sistemi distribues transparent dhe të drejtë për të shpërndarë buxhetet e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore në disa ofrues të kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar.
- Sistemi DRG prodhon të dhëna që mundësojnë një menaxhim transparent dhe efektiv të kostos së kujdesit shëndetësor dhe për këtë arsye duhet të krijojë stimuj për spitalet me qëllim të rritjes së efikasitetit.
- Zbatimi i një sistemi DRG gjithashtu do të përcaktoj synimet në një nivel ndërkombëtar



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health



- Vlerësimi i zbatimit të një sistemi të bazuar në kapitacion në kujdesin parësor shëndetësor.

Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Muller Healthcare Consulting pajtohen për idenë e një qasjeje bashkëpunuese të projektit.

Qëllimet e mësipërme do të realizohen nga secila palë përkatëse duke ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- **Ministria e Shëndetësisë së Kosovës:**

- Pjesëmarrja në komitetin drejtues të projektit;
- Pjesëmarrja në ekipin e projektit;
- Siguron qasje për ekspertët;
- Vlerëson Rekomandimet;
- Merrja e vendimeve të nevojshme;
- Pjesëmarrja në intervista;
- Sigurimi i dokumenteve dhe të dhënave;
- Sigurimi i qasjes në informacione përkatëse për projektin;
- Pjesëmarrje në punëtori;
- Siguron hapësirë pune.

- **Muller Healthcare Consulting:**

- Koordinimi i projektit;
- Hulumtim;
- Kryerja e intervistave;
- Organizimi i takimeve të projektit dhe punëtorive;
- Implementimi i një koncepti të kodimit;
- Komunikimi me aktorë të ndryshëm të projektit;
- Siguroj aplikacionin e qasjes së menaxhimit të projektit;
- Kryeni analiza të ndryshme.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health



3. Kushtet e përgjithshme

- a. Kushtet e bashkëpunimit për çdo veprimtari të zbatuar në bazë të këtij Memorandumi do të diskutohen reciprokisht dhe do të pajtohen të dy Palët para fillimit të këtij aktiviteti.
- b. Ky Memorandum ka për qëllim të përshkruaj natyrën e bashkëpunimit midis Palëve dhe nuk ka për qëllim të jetë një dokument ligjërishet detyrues.
- c. Për të realizuar dhe përmbushur qëllimet e kësaj marrëveshje, secila palë do të emërojë person/a të duhur për të përfaqësuar organizatën e tij dhe për të koordinuar zbatimin e aktiviteteve.

4. Nënshkrimi

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës dhe Muller Healthcare Consulting me nënshkrimin e tyre dëshmojnë se pajtohen me këtë Memorandum të Mirëkuptimit.

Uran Ismaili
Ministër i Shëndetësisë, Republika e Kosovës
Nënshkrimi dhe Data:

François Muller
CEO of Muller Healthcare Consulting
Nënshkrimi dhe Data:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministrastvo Inostranij Poslova
Ministry of Foreign Affairs

Prishtinë, 20 Dhjetor 2019

Nr. 481/2019

Z. Ekrem Mustafa, Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

I nderuar Z. Mustafa,

Duke shprehur konsideratën më të lartë për Ju dhe Ministrinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj, për dhënien e Pëlqimit për nënshkrimin e Memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Shendetësisë së Republikës së Kosovës dhe Muller Healthcare Consulting, si marrëveshje ndërinstitucionale në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare, kam nderin t'ju përcjell Pëlqimin për procedim të mëtutjeshëm.



Sinqerisht,

Behgjet Pacolli

Zëvendës Kryeministër i Parë &
Ministër i Punëve të Jashtme